



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 10-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më
26. 09. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini , anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi , anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Albulena Gashi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës për Komunitete
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor DBF
3. Rasim Hasani, Drejtor i Arsimit
4. Remzi Mehmeti, DMSH
5. Avni Olluri, Drejtor, DGJK
6. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
7. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
8. Fauz Xhemajli, Drejtor i administratës
9. Heset Sahiti, Drejtor i SHP
10. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
11. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
12. Jeton Zymeri, zyra pronaro juridik
13. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
14. Venera OSBE
15. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
16. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
17. Përfaqësuesit e mediave
18. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
19. Rifat Hoxha- përkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë të gjithë anëtarët e Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marrë a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Mle që askush nuk u lajmërua për fjalë, Kryesuesja të njejtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën absolute për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 8 –të e KK-së
2. Planifikimi i Buxhetit i Komunës së Lipjanit për vitet 2015-2017
3. Propozim Vendimi për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike
4. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve
5. Propozim Vendimi paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme – lokaleve afariste të Komunës
6. Propozim Vendimi paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatëgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.
7. Propozim Vendim për dhënjen në shfrytëzim të tokës – pasuri shoqërore e KK-së Lipjan, KBI-ë (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhaminë e fshatit të Gadimes së Epërme dhe
8. Propozim Vendim mbi caktimin e tarifave për tatimin në pronë

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush ndonjë pyetje.

Florent Hoxha, kërkoi që në emër të grupit parlamentarë të PDK-së që prona komunale të udhëkryqi i Magurës të definohet nga shërbimi pronësor juridik se kujt ju ka dhënë kjo pronë në shfrytëzim, për sa vite dhe kush e ka dhënë meqë Komuna më herët këtë zonë e ka shpallur zonë të interesit të përgjithshëm për 8 hektarë.

Shqetësim i dytë është çështja e maturanëve të cilët kanë protestu për ndalimin e shkurjes në ekskursion në Shqipëri dhe kërkojmë të dijmë pse ka ardhur deri te kjo e cilat janë problemet.

Shqetësimi i tretë është çështja e mos kryerjes së kanalizimit në Ribarë të Vogël.

Ramiz Qeriqi, kushdo që e ka marrë këtë Vendim për ndalimin e ekskurzionit në Shqipëri unë e përkrahi.

Nazmi Krasniqi, sa i përket ekskurzionit në Shqipëri është folë se unë e kam organizu atë protestë të nxënësve-maturantëve, por kjo nuk është e vërtetë se unë i kam organizu por në atë moment që e bëjë një gjë të tillë nuk do të jemë më anëtar i Kuvendit.

Sa i përket ekskurzionit është i paraparë me Ligj dhe askush nuk mund ta ndalojë këtë.

Blerim Gashi, parashtroj çështjen e dukurisë së qenëve endacak e gjithashtu pyeti se a do të mirret diçka në këtë drejtim në të ardhmen.

Pyetje tjetër është pse bujqit nuk i kanë marrë subvencionet.

Me që pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 8-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 8-të të Kuvendit?

Me që askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, as plotësime Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 8-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Planifikimi i Buxhetit i Komunës së Lipjanit për vitet 2015-2017

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit se buxhetin që e keni marrë ju ka ndryshime meqë qeveria ka nxjerrë një udhëzim administrativ dhe parasheh që me 3.5% të parashihet sigurimi shëndetësor pa e sqaru se si t'i gjejmë këto mjete, mirëpo dje kemi marrë një informacion nga asosiasi i komunave se qeveria do t'i mbulojë shpenzimet për sigurim shëndetësor dhe kjo është mirë meqë buxheti i komunës do të rritet me 3.5%.

Pastaj njoftoi lidhur me procedurat që janë zbatu për hartimin e këtij planifikimi buxheti duke shtuar se në 54 lokalitete është mbajtur shqyrtimi publik për këtë buxhet. Në vazhdim përmes kinoprojektorit njoftoi me të dhënat nga planifikimi i buxhetit të komunës për vitet 2015-2017 duke ju referuar planifikimit për vitin 2015.

Pastaj tha se nga shërbimet e shëndetësisë primare nga pozicioni për paga dhe meditje hiqen 1500€ dhe bartën në zyrën e Kryetarit për paga dhe meditje për vitin 2015.

Te investimet kapitale hiqen projektet e viteve 2011, 2012 dhe 2013.

Në fund kërkoi nga Kuvendi që të aprovohet ky planifikim i buxhetit me plotësimet që i paraqiti.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Merita Zeqiri-Hajrizi, e përgëzoj punën e Drejtorit lidhur me këtë planifikim të buxhetit mirëpo dua të shtoj se për Hallaq të Madh me këtë buxhet nuk është parapa asnjë projekt. Unë e përkrahu blerjen e dollapëve për shkollat fillore në Lipjan por kërkoj që të planifikohet edhe për të gjitha shkollat tjera.

Petrut Kelmendi, te tabela 4.1 shihet se janë hjek disa projekte që kanë qenë të planifikuara për vitin 2014, shembull po e marr projektin për grumbullimin e mbeturinave.

Për kanalizimin në Janjevë thuhet se nuk mjaftojnë mjete a në anën tjetër shumat për disa projekte janë fikse dhe nuk kemi paramasë dhe parallogari. Te kategoria për subvencione shihet se nuk ka rritje a është dashtë që te kjo kategori të rritet shuma.

Nazmi Krasniqi, nga Drejtoria e buxhetit u tha se për këtë planifikim buxhetor janë mbajtur diskutime publike në 54 lokalitete por nuk u tha se numri i pjesëmarrësve qytetarëve ka qenë shumë i vogël. Te planifikimi i rrugëve ku thuhet Sillovi-Smallushë propozoj që të hiqet fjala Smallushë se ajo lagje është e Sillovisë, dhe nuk duhet të figuroj fare Smallushë.

Te arsimit ishte rritë buxheti dhe për këtë më vjen mirë

Te Lipjani duhet të parashihen më shumë projekte se edhe ato asfaltime që janë parapa nuk dihet se cilat rrugë janë.

Blerim Gashi, tani është momenti më i rëndësishëm që t'i japim mendimet tona. Unë edhe në KPF i kam dhënë vërejtjet e mia e po i paraqes edhe këtu si vijon:

Është e dhimbshme që qeveria nuk ka parapa mjete për pagat të cilat janë rritë, gjithashtu problem tjetër është çështja e mjeteve për sigurim shëndetësor.

Janë parapa mjete që janë borxh vetëm për mbulimin e atyre borxheve, gjithashtu nuk kam parë asnjë projekt që do të investohet nga niveli qendror dhe pyes se a kemi mundësi që tani të parashohim ndonjë projekt që do të investohet nga niveli qendror.

Te të hyrat vetanake shihet se janë rritë dhe a kemi mundësi me i realizu këto të hyra?

Për hartimin e këtyre projekteve janë parapa 180.000,00€ dhe sipas mendimit tim janë shumë.

Për Rini, Kulturë dhe Sport nuk e pashë se është parapa ndonjë projekt.

Për subvencione janë parapa 150.000.00€ qka mendoj se janë shumë pakë dhe nuk ka mundësi t'ju ndihmohet bujqëve.

Ramiz Qeriqi, unë i kam dy kërkesa një për fshatin ku kam lind dhe për qytetin e Lipjanit ku jetoj. Për Krojmir kërkoj që të rregullohen dritaret e shkollës, ndërsa për Lipjanin kërkoj që të lihen disa kroje dhe një tualet publik.

Agron Hajdini, dëgjuam prezantimin e planifikimit të buxhetit dhe shtrohet pyetja se çka e karakterizon këtë buxhet?

Debatet për këtë planifikim të buxhetit janë mbajtur në 54 lokalitete dhe në bazë të kërkesave nga këto debate është bërë edhe planifikimi i buxhetit, gjithashtu për Lipjan është parapar rregullimi i stadionit dhe këtu nuk është përmend fare. Në fund tha se na si grup parlamentar e përkrahim këtë planifikim të buxhetit.

Edita Gashi, na e shqyrtuam këtë planifikim të buxhetit por gjerë me tani nuk u tha fare se në cilën fazë janë projektet e pa përfunduara, gjithashtu planifikimi i buxhetit për vitin 2015 është vazhdim i praktikave të keq qeverisjes së kaluar dhe planifikimi është në asfaltet etj. Në vazhdim lexoi shkresën e përgaditur me shkrim lidhur me propozimet e vetëvendosjes për këtë buxhet për të cilat deklaroi se do t'i deponoj me shkrim.

Vlora Limani-Hajnuni, tha se propozimet që i paraqitët përmes shkresës së juaj Editë është dashtë t'i dorëzoni me shkrim sikur se është paraparë me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe kjo vlenë për të gjithë anëtarët e Kuvendit e gjithashtu ju e dini se për këtë planifikim të buxhetit janë mbajtur diskutime publike dhe nuk keni marrë pjesë dhe nuk po them se është obligim ligjor, por është obligim moral ndaj votuesve e që sot është vonë për propozimet për ndryshim për të cilat deklaruat se do t'i depononi me shkrim.

Florent Hoxha, dëgjuam prezantimin e planifikimit të buxhetit dhe dihet se nevojat janë të mëdhaja të qytetarëve.

U tha se janë organizuar debate publike dhe është e vërtetë se na si opozitë nuk kemi marr pjesë në debatet publike por dua të pyes Drejtorin se sa janë harmonizuar propozimet e qytetarëve për planifikim të projekteve dhe tani e di se mbrenda këtij buxheti nuk mund të levizim.

Me këtë buxhet e pashë se për fshatin Divlakë nuk është parapa asnjë projekt a dihet se ky fshat është shpallë zonë e interesit të përgjithshëm dhe është fshat shumë me rëndësi me që aty gjatë luftës ka qenë shtabi i UÇK-së dhe nëse nuk është parapa diqka nga niveli qëndrorë, atëherë duhet që për këtë fshat të parashihet ndonjë projekt.

Te planifikimi i asfaltimeve të rrugëve nuk është përmend se cilat rrugë do të asfaltohen se shembull po e marr në Shalë janë ndoshta 40 rrugë dhe mbrenda vitit nuk mund të shtrohen, andaj krijohet konfuzitet kur nuk dihet se cilat rrugë shtrohen.

Shkelzen Hajdini, po filloj te Petriti dhe po e pyes se sa kan parapa mjete për bujqësi për vitin 2014. Na kemi parapa 15 mijë euro për bujqësi kurse ju keni parapa vetëm 13 mijë euro dhe mendoj se nuk është mirë të parashtroni këto pyetje kur dihet se ju keni qenë Drejtor i buxhetit.

Pyetja tjetër ishte se a ka paramasa dhe parallogari. Edhe këtu po them se ju për asnjë projekt nuk keni pasur paramasa dhe parallogari.

Pyetje tjetër ishte me vend se a janë planifiku projektet e vitit 2014 të cilat nuk janë realizu.

Të gjitha projektet që kanë qenë të planifikuara në vitin 2014 janë parapa në bazë të kontratave që kanë qenë përveq kanalizimit në Janjevë dhe Blinajë.

Te kontratat kolektive nuk kemi mund me i parapa këtu në buxhet me që nuk ka mjete.

Eliminimi e deponive të egëra e kemi tenderu dy herë por nuk ka konkurren asnjë kompani e licencuar. Çka nëse nuk aprovohet ridestinimi, mendoj se na do të gjindemi disi meqë edhe Kryetari edhe Ministri në bazë të Ligjit kanë të drejtë që deri në një përqindje të caktuar të nënshkruajmë.

A është problem rritja e tavanit të të hyrave vetanake, unë besoj se nuk do të kemi problem meqë gjerë tani 96% i kemi realizu të hyrat vetanake.

Te zhvillimi ekonomik Florenti tha se duhet të punohet në këtë drejtim dhe na kemi punuar në këtë drejtim dhe kemi hjekë taksën për leje të punës që konsideroj se është lehtësim për bizneset.

Pyetje tjetër ishte se a ka pasur propozim konkret nga shoqëria civile, unë me përgjegjësi e them se ato që janë propozu, janë marr parasysh. Merita e tha se Hallaqi i Madh është mbetë anash unë po them se nuk është mbet anash se është parapa ujësjellësi me projektin për 20 fshatra.

Petrit Kelmendi, unë te subvencionet kërkova që nga zyra e Kryetarit të bëhet subvencionimi i bujqësisë dhe kulturës.

Te ridestinimi keni futë projekte të reja a duhet me ditë se nuk pranohen projektet e reja me ridestinim.

Për fshatin Dobrajë nuk dihet se a është faza e parë apo faza e dytë për ndërtimin e sallës apo është projekt i ri.

Vlora Limani-Hajnuni, materialin e keni marrë me datën 15 Petrit dhe nuk e keni pa të arsyeshme që vërejtjet dhe plotësimet t'i paraqitni te Drejtori i buxhetit.

Xhevat Olluri, nuk është faji i Drejtorit për planifikim të këtij buxheti kur dihet se 70% e këtij buxheti shkon në paga dhe medita dhe me këtë zvogëlohen mjetet për investime kapitale. Pastaj tha se ka qenë mirë që të theksohet se në bazë të cilave kritere janë parapa projektet.

Te plani i efijencës është mirë me parapa projekte si shembull kur bëhet ndërtimi i objekteve të reja të bëhet me dritare të cilat përfshihen me efijencën.

Blerim Gashi, unë i ngrita shqetësimet dhe ato janë fakte që i thash. Drejtori për projektet e parapara tha me ymyt nuk ka me ymyt, na duhet të planifikojmë projekte të cilat janë të domosdoshme si shembull po e marrë shkollën e Rubovcit. Pse nuk e keni planifiku si projekt me

nivelin qëndror dhe nëse nuk e pranon qeveria atëherë le të mbetet. Te kultura dhe rinia ka investime por pyes se a ka mundësi të finansohet ndonjë klub për gara nga subvencionet.

Enver Kozhani, në planifikim është parapa zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Ribar të Madh dhe Dobrajë, andaj pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike se cilat pjesë të kanalizimeve do të zgjerohen dhe a është përfshi lagja Rama.

Ukë Kryeziu, gjatë shqyrtimit të këtij planifikim u pa se ky buxhet nuk arrinë as për së afërmi të përmbushë nevojat.

Për vitin 2015 sipas këtij planifikimi shihet se nuk është parapa mirëmbajtja e hapsirave të gjelbërta për qytetin e Lipjanit dhe është mirë që për të ardhmen të parashifet.

Pastaj propozoj që mundësisht të parashihet mirëmbajtja e varrezave të Dëshmorëve dhe martirëve të luftës të Komunës sonë.

Zoran Çirkoviq, në emër të bashkësisë serbe të cilët i përfaqësoj unë dua të theksoj se kjo bashkësi në mënyrë të barabart ka marrë pjesë në shqyrtimin e këtij projekt buxheti dhe me këtë buxhet është parapa ndriqimi publik në Grackë të Vjetër e që nuk është bërë rastësisht por ka qenë kërkesë e banorëve të fshatit Grackë.

Vlora Buja, propozoj që mundësisht për Bujan të parashihet mirëmbajtja e kanalizimit, rrethoja e shkollës dhe hapja e një pusi për shkollë.

Burbuqe Ilazi, kërkoi që për fshatin Kleçkë të parashihet kanalizimi dhe rregullimi i shkollës.

Valbona Shillova, kërkoi që për Topliqan mundësisht të parashihet ujësjellësi me që aty nuk ka ujë të pijshëm.

Feriz Hasani, për fshatin Glllogovc sipas këtij planifikim është parapa përfundimi i shkollës dhe rrethoja por kërkoi që për fshatin Glllogovc të parashihet edhe trotuari me që ky fshat është paralagje e Lipjanit.

Ali Stublla, për fshatin Jeta e Re asnjë projekt nuk është parapa që tri vite dhe kjo lagje ka mbi 1500 banorë dhe kanalizimi ka mbetur në gjysëm, andaj është mirë që të parashihet.

Ramiz Qeriqi, nuk e di Drejtor se a jini të njoftuar se kanalizimi në Krojmir është i pa përfunduar, gjithashtu më heret kam kërku që të parashihet mirëmbajtja e monamenteve historike dhe ngritjen e një pllake me emra që i simbolizon Dëshmorët dhe martirët e luftës në mënyrë që kur të na viziton ndonjë faktor i huaj i tregojmë se na kemi një histori dhe na kemi dhënë për këtë vend.

Heset Sahiti, me parashikim të këtij buxheti është parapa rehabilitimi i kanalizimit në Ribarë të Madh, Ribarë të Vogël dhe Kraishtë me që ju e dini se te gropat septike janë duke u shkaktuar dëme.

Sa i përket kanalizimit për lagjen Rama në Ribarë të Madh është i parapar kanalizimi.

Ali Stublla, unë kam dëgju se në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport janë 50 mijë euro të parapara për vitin 2014 dhe pyes pse nuk po realizohen ato mjete dhe pse nuk po i plotësoni kërkesat e klubeve sportive.

Me që diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim planifikimin e buxhetit me plotësimet që ceku Drejtori i buxhetit që nga shërbimet e shëndetësisë primare nga pozicioni për paga dhe meditje hiqen 1500€ dhe bartën në zyrën e Kryetarit për paga dhe meditje për vitin 2015 dhe nga investimet kapitale hiqen projektet e viteve 2011, 2012 dhe 2013 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për 2 kundër 10 apstenime miratoi planifikimin e buxhetit me plotësimet e Drejtorit të buxhetit dhe lidhur me të njejtin mori këtë:

VENDIM
MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2015-2017

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Buxheti për vitet 2015-2017 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Buxheti për vitet 2015-2017 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2015	VITI 2016	VITI 2017
Grant i Përgjithshëm	4,906,685.00	4,557,764.00	4,631,852.00
Grant Specifik i Arsimit	4,788,278.00	4,836,050.00	4,859,309.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,361,955.00	1,421,338.00	1,453,700.00
Të hyrat vetanake	1,342,336.00	1,345,575.00	1,359,375.00
TOTALI	12,399,254.00	12,160,727.00	12,304,236.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategoritë ekonomike si vijon:

KATEGORITË EKONOMIKE	VITI 2015	VITI 2016	VITI 2017
Paga e Mëditje	8,297,000.00	8,383,896.00	8,389,859.00
Mallra dhe Shërbime	956,030.00	864,012.00	868,048.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	198,390.00	221,490.00	211,990.00
Subvencione dhe Transfere	157,000.00	156,500.00	156,000.00
Investimet Kapitale	2,790,834.00	2,534,829.00	2,678,339.00
TOTALI	12,399,254.00	12,160,727.00	12,304,236.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.

Neni 6.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

Pas përfundimit të kësaj pike Kryesuesja dha pauzë në ora 13,⁰⁵ deri në ora 14,00
Pas pauzës në ora 14,15 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së tretë.

III

Propozim Vendimi për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni njoftoi të pranishmit me procedurat e nxjerrjes së propozim Vendimit duke shtuar se ky Komitet do të ketë 5 anëtarë sipas strukturës si vijon: 1 LDK, 1 PDK, 1 IQL-AAK-LDD, 1 AKR dhe 1 nga subjektet politike W, PSD, IQS dhe PD me rrotacion nga 3 muaj.

Pastaj pyeti se kush ka propozime?

Burbuqe Fazliu propozoj Labinot Shahinin

Florent Hoxha propozoj Ragip Zejnullahun

Hajrije Salih propozoj Rizah Bajraktarin

Blerim Gashi propozoj Albulena Gashin

Vlora Limani – Hajnuni propozoj subjektet politike 1 LDK, 1 PDK, 1 IQL-AAK-LDD, 1 AKR dhe 1 nga subjektet politike W, PSD, IQS dhe PD me rrotacion nga 3 muaj.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimet dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave aprovoi propozimet.

Floren Hoxha, kërkoi sqarim se cili subjekt do ta udhëheq këtë Komitet, gjithashtu njoftoi Kuvendin se kanë qenë në takim dhe kanë kërkuar që PDK-ja të udhëheqë edhe një Komitet në mënyrë që të propozojnë anëtarët për komitete tjera.

Enver Kozhani, nëse LDK-ja udhëheqë këtë Komitet atëherë po i bëhen 3 komitete që i udhëheqë kurse PDK-ja po mbetet vetëm një komitet a është subjekti më i madh në Kuvend.

Kryesuesi i KPF-së është i paraparë me Ligj

Florent Hoxha, kërkoj që këtë komitet ta udhëheqë PDK-ja

Vlora Limani-Hajnuni, unë kam konsideru se LDK-ja udhëheqë dy komitete por kisha qenë gabim se të gjitha subjektet e kanë nga 1Kryesues të Komiteteve.

Daut Azemi, mendoj se këtë Komitet duhet ta udhëheq LDK me që si grup parlamentar jemi barabar me PDK-në dhe ne si grup parlamentar i LDK-së jemi pajtu që në këtë Komitet të propozohet Labinot Shahini.

Feriz Hasani, unë e di se me vota neve na mundeni por ka qenë mirë që kësaj radhe të bëni kompromis dhe ky komitet t'i ipet PDK-së.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit se Kuvendi me 17 vota për 8 kundër dhe 2 apstenimle miratoi këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

Neni 1 Përbërja e Komitetit

1. Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Shërbime Publike i Kuvendit të Komunës së Lipjanit nga përbërja e anëtarëve të Kuvendit si vijon:

1. Labinot Shahini, Kryesues
2. Ragip Zejnullau, anëtar
3. Rizah Bajraktari, anëtar
4. Albulena Gashi, anëtar
5. Subjektet politike, VV, PSD, IQS dhe PD me rotacion nga 3 muaj

Neni 2 Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komitetit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 3 Përgjegjësitë e Komitetit

3.1 Komiteti për Shërbime publike nga kompetencat që ka Komuna në bazë të dispozitave ligjore dhe Statutit të Komunës nga lëmi i shërbimeve publike do t'i kryej punët si vijon:

- a) Të inicojë miratimin e akteve nga lëmi i shërbimeve publike,
- b) T'i parashtrojnë Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratit për shërbime publike mendime dhe sugjerime për zgjidhje adekuate përkitazi me çështjet nga lëmi i shërbimeve publike,

Neni 4 Puna e Komitetit

Komiteti për çështjet e cekura mban më së shumti 5 (pesë) mbledhje brenda vitit.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Me Vendim të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit, Drejtorati për Shërbime Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa një kopje të ruhet në dosjet e materialit të Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

IV Propozim Vendimi për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit duke shtuar se një anëtarë i këtij komisioni emërohet nga Kryetari i Komunës i cili ka emëruar Haset Sahitin ndërsa dy anëtarë të tjerë caktohen nga anëtarët e Kuvendit.

Vlora Limani-Hajnuni, unë mendoj se dy anëtarët të tjerë duhet të caktohen nga dy partitë më të mëdha në Kuvend.

Enver Kozhani, propozimi i Vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve është në përputhje me ligjin për ndërmarrje publike dhe përbërja e komisionit, detyrat si dhe përgjegjësitë e këtij komisioni.

Ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim e gjithashtu kërkojmë që një anëtarë i Kuvendit nga radhët e PDK- së të emërohet në këtë komision. Pastaj pyeti se cili është raporti i këtij komisioni me aksionarë sa i përket mbajtjes së takimeve, sa takime mbahen gjatë vitit dhe kush ka obligim ta bëjë pagesën e anëtarëve të këtij komisioni, a paguhen me meditje apo me pagë mujore. Këtë pyetje e parashtrova me që këto informacione mungojnë në këtë Vendim.

Linda Shahini, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim dhe për anëtarë të këtij komisioni propozoj Arton Retkoceri.

Blerim Gashi, na e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim në KPF dhe ende nuk e kam të qartë se këta tre anëtarë a shkojnë në Bordin e ndërmarrjeve apo këta tre do të caktojnë në Bordin e ndërmarrjeve ndonjë anëtarë.

Arben Bahtiri, me sa e di unë këta aksionar i japin raport Kuvendit dhe këta aksionar e zgjedhin anëtarin e Bordit a na kemi dy kompani të pastrimit dhe ujësjellësit.

Floren Hoxha, për anëtarë të këtij komisioni propozoj Enver Kozhanin.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit së bashku me propozimet e anëtarëve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për 2 apstenime miratoi këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për ushtrimin e të drejtave të Komunës në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave” Pastrimi” sh.a Prishtinë (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon :

1. Heset Sahiti, anëtar, i emëruar nga Kryetari i Komunës,
2. Arton Retkoceri, anëtar, i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe
3. Enver Kozhani anëtar, i emëruar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komisioni do të veprojë në emër të Komunës dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare .

Komisioni i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore më së largu deri me 31 janar pas skadimit të vitit paraprak mbi performance e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të Ligjit për Ndërmarrjet publike. Komisioni do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes publike lokale në interes të Komunës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Me Vendim të njoftohen anëtarët e komisionit, MAPL ndërsa një kopje të ruhet në dosjet e materialit të Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendimi paraprak për dhënen në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtëshme – lokaleve afariste të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Latif Ramadanit Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Arben Bahtiri, na e përkrahim këtë propozim Vendim dhe dihet se si janë duke u shfrytëzuar këto lokale ku përfitues i një lokali i ka dhënë dikujt tjetër lokalin dhe nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunës për shfrytëzim të lokalit. Unë propozoj që në të ardhmen të ndërmirren hapa edhe për lokale të tjera.

Ramiz Qeriqi, këto lokale a janë të lira apo është duke i shfrytëzuar dikush?

Blerim Gashi, na e përshëndesim këtë Vendim dhe mendimi im se ai që e ka shkelë kontratë t'i muret lokali.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe dihet se për këto lokale disa i kanë kontratat deri në vitin 2017. Gjithashtu ne edhe më herët kemi konstatu se ka pasur shkelje të kontratave dhe për qdo shkelje të kontratës Komuna duhet t'i merrë masat ligjore. Unë e di se qiraja për këto lokale i ipet Komunës, ndërsa obligimet për rrymë, ujë etj i marrin kompanitë. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Vendim.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për 2 apstenime miratoi këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME-LOKALEVE AFARISTE TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim paraparak përcaktohet dhënja në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, paluajtshmeritë-lokalet afariste që gjinden në zonën kadastrale në Lipjan si në vijim:

1.1. Lokalet afariste 5 (pesë), prej tyre 4 (katër) me sipërfaqe prej 35m², 1 (një lokal) me sipërfaqe prej 58,91m², gjinden në rrugën "Lidhja e Prizrenit" ngastra kadastrale P-71409044-01926-0.

1.2. Lokali afarist me sipërfaqe prej 65m² gjindet në Sheshin "Adem Jashari" ngastra kadastrale P-71409044-01767-1.

1.3. Lokalet afariste 2 (dy) me sipërfaqe prej 25 m² dhe 39m², gjinden në rr."Lidhja e Prizrenit" ngastra kadastrale P-71409044-01920-0.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi pronat-lokalet afariste ipen në shfrytëzim në afat prej 10 vitesh nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

3. Procedurën e ankandit publik e udhëheq Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori për çështje pronëso-ro-juridike, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

6. Me Vendim të njoftohen Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, MAPL ndërsa një kopje të ruhet në dosjet e materialit të Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronave të paluajtëshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit .

Vlora Limani- Hajnuni, Kryesuese hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, unë vij nga ajo zonë ku gjinden këto prona të paluajtëshme të Komunës dhe e di se si është ajo zonë dhe lirisht po them se është tmerr nga mbeturinat që janë hudhë aty dhe konsideroj se nëse kjo pronë i ipet dikujt në shfrytëzim sigurisht se do ta rregulloj atë pjesë, andaj ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, na e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe si grup parlamentar jemi kundër këtij Vendimi duke e arsytuar se nuk janë plotësu kushte ligjore për aprovim të këtij Vendimi dhe kërkoj nga Drejtori sqarim se a janë plotësu kriteret për këtë Vendim.

Blerim Gashi, pyeti se a ka ndonjë kërkesë konkrete për këtë pronë e gjithashtu kërkoj që të identifikohen të gjitha pronat komunale.

Ilir Tasholli, sa i përket pyetjes së Florent Hoxhes mund të them se ky Vendim është në Përputhshmëri me planin zhvillimor dhe mund të ipet në shfrytëzim për zhvillimin e veprimtarive ekonomike. Sa i përket pyetjes së Blerimit nuk ka kërkesë konkrete por e di se ka investitorë të shumt që janë të interesuar për investime në prona të tilla.

Xhevat Olluri, sipas shifrave del se aty janë 400ha e nuk e di a unë e kam gabim apo është gabim teknik.

Nazmi Krasniqi, kërkoj që Drejtorët të jenë interpretues të mirë dhe të arsyetojnë vendimet si duhet, unë jam kundër këtij propozim vendimi se nuk po shoh diçka konkrete aty dhe aty nuk është zonë industriale.

Ilir Tasholli, unë e thash edhe më parë se nuk ka asnjë kërkesë dhe asnjë marrëveshje për këtë pronë dhe ky vendim është në përputhshmëri me planin zhvillimor dhe është vendim paraprak.

Florent Hoxha, Drejtori po na thotë se pronat në fjalë janë në përputhshmëri me planin zhvillimor dhe na kemi me kërkim me shkrim me na njoftu meqë na kemi pasur edhe një kërkesë në AKP për ndërrim të pronës atje dhe gjerë me sot nuk e dijmë si është vendos. Gjithashtu shtoi se për rastin në fjalë nuk është zonë ekonomike.

Sefer Tasholli, Nënkryetar, ato parcela që janë propozu janë lënë anash dhe atë pjesë e ka pasur minjera e thengjillit dhe në ato prona nga nxjerrja e thengjillit janë bërë gropa dhe tani janë shëndërru në deponi mbeturinash. Pastaj tha se po më vjen mirë që Florenti po përpiket tani t'i mbron pronat a besoj se të gjithë e dini se nga ky Kuvend janë dhënë shumë toka në shfrytëzim me nga 5-10 hektarë tokë e gjithashtu janë dhënë prona edhe pa vendim të Kuvendit.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për 9 kundër 1 apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim paraprak përcaktohet dhënia në shfrytëzim afatëgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 4.00,00 ha nga pjesët e ngastrave kadastrale si në vijim:

1.1 Ngastra kadastrale P-71409059-00555-0 në vendin e quajtur “Balkan” me sipërfaqe prej 2.00,00 ha (sipërfaqe e përgjithshme prej 119407m²) kullosë e kl.4-të e evidentuar në Certifikatën nr.14-6302 ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan.

1.2 Ngastra kadastrale P-71409059-00559-0 në vendin e quajtur “Balkan” me sipërfaqe prej 2 .00,00 ha (sipërfaqe e përgjithshme prej 259945m²) kullojë e kl.4-të e evidentuar në Certifikatën nr.14-6303 ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan.

2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi pronat e paluajtshme ipen në shfrytëzim në afat prej 15-99 vjet nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

3. Procedurën e konkursit publik e udhëheq Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 15 Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori për çështje pronësoro-juridike dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër..

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi pushojnë të vlejnë të gjitha vendimet e mëhershme, kontratat si dhe marrëveshjet lidhur me dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave të cilat janë objekt i këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

7. Me Vendim të njoftohen Sektori pronësoro juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, MAPL, ndërsa një kopje të ruhet në dosjet e materialit të Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës – pasuri shoqërore e KK-së Lipjan, KBI-ë (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhaminë e fshatit të Gadimes së Epërme

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Drejtorit të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport Basri Hashani i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, fillimisht më lejoni të falënderoj Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e Drejtorive për rezultatet që kanë arritur gjatë këtyre 9 muajve. Sa i përket këtij propozim vendimit ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Burbuqe Ilazi, edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim. Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimet dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, KBI-se (Këshilli i Bashkësisë Islame) PËR XHAMINË E FSHATIT GADIME E EPËRME

Neni 1

Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim toka-Pasuri Shoqërore e KK Lipjan me sipërfaqe prej 1615 m², KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan.

Neni 2

Sipërfaqja e tokës sipas pikës 1 të këtij vendimi ndahet nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.i njësisë: P-71409020-01438-1 me kulturë Madem Rëre me sipërfaqe prej 8085 m², e evidentuar në Të dhënat Bazë për Njësi në Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme ZK Gadime e Epërme-Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 3

Kjo sipërfaqe e tokës si në nenin 1 të këtij Vendimi jepet në shfrytëzim afatgjatë Xhamisë në fshatin Gadime e Epërme, për ushtrimin e rregullt të aktiviteteve fetare.

Neni 4

Me këtë Vendim obligohet DGJK-Spektori për Kadastër dhe Gjeodezi që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të shfrytëzimit të pjesës së paluajtshmërisë nga KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan siq përcaktohet në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Spektori pronëso-ro-juridik dhe DGJK-Spektori për Kadastër dhe Gjeodezi.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 8(tetë) ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 7

Me Vendim të njoftohen Spektori pronëso-ro-juridik, DGJK-Spektori për Kadastër dhe Gjeodezi. Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan, MAPL-ja, ndërsa një kopje të ruhet në dosjet e materialit të Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

VIII

Propozim Vendim mbi caktimin e tarifave për tatimin në pronë

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit duke shtuar se emërtimi duhet të bëhet Rregullore e jo siqë është thënë Vendim dhe duhet të ndryshohet fjala përcakton të thuhet rregullon.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, realizimi i të hyrave vetanake është i mirë dhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë Vendim apo Rregullore e cila cakton tarifën në pronë sipas zonave.

Ali Stublla, kisha me pyetur Drejtorin se a ka pasur takime me biznese dhe si mund të krahasohen një soj si lokalet afariste të vogla me disa biznese më të mëdhaja dhe së paku kërkoj që pika 4 të reduktohet.

Edita Gashi, propozoj që në këtë Vendim të shtohet edhe një nenë ku lirohen nga tatimi disa kategori.

Vlora Limani-Hajnuni, nëse doni me bërë ndryshime atëherë duhet t'i paraqitni me shkrim më herët për shkak të procedurave.

Ramiz Qeriqi, shumë herë po përmendet fjala të zhdukurit e UÇK-së dhe propozoj që kjo fjalë të hiqet nga teksti me që nuk ka të zhdukur të UÇK-së.

Petrît Kelmendi, kjo Rregullore është e bazuar në Ligj dhe në si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me propozimin e Drejtorit për ndryshim të emërimit prej fjalës Vendim të shëndrrohet në Rregullore dhe aty ku thuhet përcakton të thuhet rregullon dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për 1 kundër miratoi këtë:

RREGULLORE

MBI ÇAKTIMIN E TARIFAVE PËR TATIMIN NË PRONË

I.DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore rregullohen tarifat tatimore mbi tatimin në pronë bazuar në vlerën e tregut për m² të kategorive të objekteve që gjenden në zonat tatimore të përcaktuara prej nenit 2 deri në nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Tarifat tatimore sipas llojeve të objekteve

Nr.	LLOJI I OBJEKTIT	BAZA E VLERËSIMIT Euro/m ²				TARIFA
		Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	
1.	Apartament banimi	400.00 €	300.00 €	200.00 €	150.00 €	0.15%
2.	Shtëpi banimi	400.00 €	300.00 €	200.00 €	150.00 €	0.15%
3.	Komerciale - Dyqan	600.00€	400.00€	300.00 €	200.00 €	0.30%
4.	Komerciale - Zyrë	600.00€	400.00€	300.00 €	200.00 €	0.30%
5.	Komerciale - Hotel	600.00€	400.00€	300.00 €	200.00 €	0.30%
6.	Komerciale - Restorant	600.00€	400.00€	300.00 €	200.00 €	0.30%
7.	Komerciale - Pishinë	00.00 €	00.00 €	00.00 €	00.00 €	0.00%
8.	Komerciale - Fushë sportive e hapur	80.00 €	80.00 €	80.00 €	80.00 €	0.30%
9.	Komerciale- Fushë sportive e mbyllur	80.00 €	80.00 €	80.00 €	80.00 €	0.30%
10.	Komerciale - Pompë Benzine	600.00€	400.00€	300.00 €	200.00 €	0.30%
11.	Komerciale- Institucione private të edukimit	600.00€	400.00€	300.00 €	200.00 €	0.30%
12.	Komerciale (pistat e aeroportit)		400.00€			0.15%
13.	Fabrikë për prodhim apo përpunim	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €	0.20%
14.	Industrial- punishte-punëtori	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €	0.20%
15.	Industrial – Depo, Magazinë	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €	0.20%
16.	Industrial – Shërbimet (ujësjellë, kanalizim, mbeturina, rrymë elektrike)	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €	0.20%
17.	Objektet bujqësore (fermë e kapaciteteve të mëdha, fermë komerciale)	200.00 €	150.00 €	100.00 €	100.00 €	0.15%
18.	E papërfunduar	160.00 €	120.00 €	80.00 €	60.00 €	0.15%

II.ZONAT TATIMORE

Neni 3

Zonat

Tarifat tatimore të përcaktuara me këtë Rregullore do të aplikohen për objektet që gjenden në katër zonat tatimore të Komunës.

Neni 4

Zona e I-rë tatimore

Zona e I tatimore përfshin objektet të cilat sipas sistemit të adresave gjenden në sheshet dhe rrugët e qytetit të Lipjanit , si vijon:

1. Sheshi Adem Jashari
2. Rruga Hamzë Jashari
3. Rruga Lidhja e Prizrenit
4. Rruga Skenderbeu
5. Rruga Shqipëria
6. Rruga Haradin Bajrami
7. Rruga Shën Flori
8. Rruga Gjergj Fishta

Neni 5

Zona II

Zona e II tatimore përfshin objektet të cilat gjenden në rrugët e qytetit të Lipjanit si vijon:

Avdi Kelmendi
Fehmi Agani
Bajram Gashi
Haxhi Kleqka
Fehmi Agani
Haxhi Kleqka
Shën Lauri
Sadik Shala
28 Nëntori
Xhavit Kozhani
Isa Olluri
Tahir Sinani
Zylfie Gashi
Mbreti Zog
Fatmir Reqica
Ganimete Terbeshi
Ulpiana
Aleksander Stipqeviq
Rexhep Akllapi
Qamil Olluri
Halil Metaj
Enver Olluri

Gani Azemi
Ramiz Shala
Qerim Banulla
Fehmi Jupa
Vezir Kolshi
Avdi Avdiu
Agim Ademi
Bejtush Gerbeshi
Xhevdet Breznica
Gafurr Hyseni
Arsim Zeqiri
Mbretresha Teutë
Shaqir Hoxha
2 Korriku
Hamdi Bislimi
Nëna Terezë
Malet E Sharrit
Anton Qeta
Bajram Curri
Ismail Luma
Ibrahim Krasniqi
Sali Rexha
Ismail Dragusha
Millosh Kopiliqi
Mihailo Pupin
Lekë Dukagjini
Luigj Gurakuqi
Aziz Kelmendi
12 Qershori
Martirët Lipjan
Lulzim Llugiqi
Bashkim Krasniqi
Pjeter Bogdani
Një Maji
Liburna
Shkolla E Mesme
Isa Dema
Zenel Emerllahu
Maliq Hoti
9 Maji
Myzaqete Begolli
Hysni Xhemaili
Idriz Zejnullahu
Iliria
Sami Frashëri
Zekë Luma
Nezë Buja
Sadri Duhla
Shyqeri Haziri
Jeton Fazliu
Armend Ahmeti

24 Marsi
Pranvera 81
7 Shtatori
Ali Podrimja
Justinjani
Habibe Shehu
Ali Hadri
Mbreti Agron
Besëlidhja
Haxhi Zeka
Hamit Bytyqi
Miftar Sopi
Butrinti
Shefki Salihu
Rashit Mehmeti
Revolucioni I Qershorit
Mic Sokoli
Avni Rustemi
1 Qershori
Afrim Zhitia
Fahri Fazliu
Halit Akllapi
Nuhi Berisha
Rexhep Mala
Idriz Seferi
Epopeja Uçk
Burimi
Bahri Fazliu
Flaka E Janarit
Martirët E Akllapit
Jetish Akllapi
26 Marsi
Milazim Petrova
Komandant Kumanova
Shën Flori

Në zonën e dytë llogariten edhe të gjitha objektet e banimit dhe të biznesit që gjenden pranë rrugëve magjistrale Prishtinë-Ferizaj, Prishtinë-Prizeren, Lipjan-udhëkryqi I Banullës, si dhe Aeroporti I Prishtinë

Neni 6 Zona III

Zona III tatimore përfshin objektet të cilat gjenden në fshatrat e Komunës së Lipjanit si vijon:

Banulla, Bujani, Qellapeku, Bregu i Zi, Qylaga, Gadimja e Poshtme, Gllanica, Gllavica, Gllgovci, ,Vrella e Goleshit, Gadimja e Epërme, Gumnasella, Janjeva, Kojska, Kraishta, , Llugagjia, Magura, Dobraja e Madhe, D. e Vogël, Hallaqi i Vogël, Gracka e Vogël, Ribari i Vogël, Marefci, Medveci, Babushi i Muhaxherve, Rufci i Ri, Pojata, Poturofci, Rubofci, , Sllovia, Smallusha, Gracka e Vjetër, Rufci i Vjetër, Topliqani, Torina, Hallaqi i Madhë, Ribari i Madhë, dhe Jeta e Re.

Neni 7
Zona e IV-të tatimore

Zona IV tatimore përfshin objektet të cilat gjenden në fshatrat e Komunës së Lipjanit si vijon: Hanrofc, Bajica, Brusi, Bukovica, Divjaka, Kleqka, Kroimiri, Leletiqi, Blinaja, Mirena, Akllapi, Okosnica, Plitkoviqi, Risinovci, Shalla, Shisharka, Teqja, Tërbufci, Varigovci, Vogoqinca, Vrella e Gadimes, Vërshevc dhe Zllakuqani.

II.DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 7
Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa – Sektori i Tatimit në Pronë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1.Rregullorja hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e shpalljeve të Kuvendit Komunal, ndërsa normat tatimore të përcaktuara me këtë Rregullore do të aplikohen në bazë vjetore prej datës 01.01.2015.

2.Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr 1Nr.432-13422 mbi tatimin në pronë e datës 21.12.2014.

Shtesë: Rregullorja.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,¹⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni